



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 1080/Prot.
11

Tiranë, më 18/02/2022

URDHËR

NR. 45, DATË 18/02/2022

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHËRIN NR. 595, DATË 25.10.2021
“PËR MARRJEN NË DORËZIM TË AKTEVE NOTERIALE, REGJISTRAVE TË ISH-
NOTERIT ASIM ZEKAJ”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6 dhe 7, të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, nenit 4 dhe 67 pika 2 të Ligjit nr. 110/2018, “Për Noterinë”,

URDHËROJ:

1. Ndryshimin e pikës 4, të Urdhërit nr. 595, datë 25.10.2021, si vijon:

Arkiva t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 60 ditor, noteres, së Degës Vendore të Noterisë Tiranë **znj. Xhoana Omari**, pas verifikimit nga ana e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të arkivit, se noteria plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivit dhe kryerjen sa më të shpejtë e cilësor të shërbimit ndaj të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.

2. Ndryshimin e pikës 4, të Urdhërit nr. 595, datë 25.10.2021, si vijon:

Komisioni i ngritur në zbatim të këtij urdhri kryen dorëzimin e regjistrave dhe akteve noterialë noteres **znj. Xhoana Omari**, të caktuar nga Dega Vendore e Noterisë Tiranë, si dhe kryen asgjësimin e vulës së thatë dhe vulës së njomë, së ish-noterit Asim Zekaj.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë, të marri masat e nevojshme për zbatimin dhe njoftimin e këtij urdhëri personave përgjegjës, si dhe ish-noterit Asim Zekaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

ULSI MANJA

